



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

Tregu energjistik Shqipëri-Kosovë, takim mes ministrave Gjijnuri e Lluka

2017-10-03 15:49:00



Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë Damian Gjijnuri priti në takim Ministrin e Zhvillimit Ekonomik të Kosovës Valdrin Lluka dhe delegacionin që e shoqëronte.

Gjatë bashkëbisedimit, palët u ndalën tek hapat e ndërmarra deri më tani në kuadër të projektit të krijimit të tregut të përbashkët të energjisë elektrike mes Shqipërisë dhe Kosovës.

“Një bashkëbisedim i frytshëm mes dy delegacioneve dhe që i paraprin mbledhjes së përbashkët të qeverive. Kemi një punë të mirë të nisur tashmë me Kosovën për krijimin e tregut të përbashkët energjistik. Vendosëm të riaktivizojmë grupet e punës për ecjen përpara drejt unifikimit të tregjeve. U diskutua vazhdimi i procesit të krijimit të Bursës energjitike në Shqipëri dhe gadishmëria e Kosovës për të marrë pjesë në të”, nënvizoi ministri Gjijnuri.

Ministri Lluka vuri theksin tek perspektiva e bursës shqiptare të energjisë dhe përfshirja e Kosovës në të.

“Diskutuam tregun e përbashkët, bursën shqiptare të energjisë, pjesë e të cilës ne shpresojmë të jemi. U angazhuam që grupet të jenë më aktive për intensifikimin e punës mes dy shteteve. Transmisioni i Kosovës do të jetë pjesë e bursës shqiptare në formë aksionari dhe grupi i punës do të definojë më tej detajet. U dakordësuam të kemi edhe një grup kordinues në nivel politik që të ndihmojë për ecjen më shpejt të axhendës së përbashkët”, u shpreh Lluka.

Dy ministrat u angazhuan për rakordimin e mëtejshëm të veprimeve për vendosjen në funksionim të linjës së interkonjeksionit 400 kilovolt mes dy vendeve.

“Diskutuam edhe për një çështje shumë të rëndësishme që është kthyer në një problem, jo mes vendeve tona por me vende të tjera të rajonit. Po flas për vënien në funksionim të linjës së

interkonjeksionit Shqipëri-Kosovë, një investim i rëndësishëm nga vende të Bashkimit Evropian, projekt në kuadër të interkonjektivitetit dhe në thelb të integrimit të vendeve tona. Shqipëria do të luajë rolin e mbështetësit për këtë projekt, do të llobojmë fort të dy vendet që në çdo forum ku të jemi tua vëmë në dukje partnerëve evropianë se vënia në punë e kësaj linje është alfa dhe omega e çdo gjëje për integrimin energjistik të dy vendeve. Do të bëjmë gjithçka që kjo çështje të ngrihet në nivelet më të larta”, u shpreh ministri Gjijknuri.

Në vlerësimin e ministrit Llukaj, linja e transmetimit mbetet jo aktive për shkaqe politike.

“Vjen për shkak të problemeve që ne kemi me Serbinë. Shqipëria do vazhdojë të na përkrahë në këtë drejtim. Kjo është mjaft e rëndësishme pasi si Kosovë kemi nevojë më shumë se kurrë që të jemi pjesë e rrjetit të transmetimit të Evropës”, sqaroi Llukaj.